



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201900574/5

Tiranë ___/___/2019

Lënda : *Rekomandim për zgjerimin e ambienteve të prindërimit në distancë për të paraburgosurat dhe të dënuarat me burgim që janë akomoduar në IEVP "Ali Demi", Tiranë.*

DREJTORIT TË INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE
PENALE "ALI DEMI"
Tiranë

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË BURGJEVE
Tiranë

Sikurse ju kemi vënë në dijeni në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja M.C.. Në ankesën e dërguar ankuesja shkruan se ka një fëmijë të mitur të quajtur E.C., e datëlindjes 26.8.2017. Aktualisht ajo ndodhet e paraburgosur në IEVP "Ali Demi" Tiranë. Ankuesja pretendon se, në datën 12.04.2019 është njoftuar nga punonjësit e administratës së këtij institucioni se do t'i reduktohen takimet me fëmijën, e cila jeton me prindërit e saj. Përveç sa më sipër, ajo shkruan se gjatë qëndrimit të këtij institucioni ka pasur sjellje korrekte dhe nuk ka krijuar asnjë shkak për t'u ndëshkuar me një masë të tillë.

Në bazë të kërkesës tonë, IEVP "Ali Demi" me shkresën nr. 909 prot., datë 13.05.2019, ndërmjet të tjerave na informoi se, për të paraburgosurat dhe të dënuarat që trajtohen në këtë institucion, realizimi i takimeve me familjarët, miqtë dhe të afërmit bëhet në bazë të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, i ndryshuar dhe Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr. 437, datë 20.05.2015.

Sipas këtyre akteve normative, të paraburgosurit dhe të dënuarit kanë të drejtë të takohen 4 herë në muaj me familjarët, miqtë dhe të afërmit e tyre. Ndërsa të paraburgosurit dhe të dënuarit e mitur kanë të drejtën për të bërë 8 takime në muaj. Drejtori i IEVP-së mund të japë takime shtesë të arsyetuara për të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Në rastet e prindërimit në distancë, i cili synon forcimin e marrëdhënieve me familjen dhe përgatitjen për riintegrim me përqëndrim të veçantë tek të miturit dhe gratë, takimet bëhen në mjedise të veçanta të institucionit, të përshtatura për zbatimin e këtij programi, ku të dënuarat dhe të paraburgosurat shpenzojnë deri në 8 orë me familjarët.

Sipas shkresës të dërguar nga IEVP “Ali Demi”, në kohën që ankuesja është akomoduar në këtë institucion ka pasur shqetësime psikologjike edhe për shkak se kishte një fëmijë të mitur 8 muajshe për të cilën ka kërkuar që t’i mundësohej realizimi i takimeve me të sepse e ushqente me gji. Në komisionin e pritjes asaj i është bërë me dije e drejta për të mbajtur fëmijën e mitur në çerdhen e institucionit, por ajo ka refuzuar që ta mbante atë në këtë institucion.

Nisur nga specifikat e rastit në fjalë, nga institucioni është gjykuar dhe vlerësuar e arsyeshme krijimi i mundësisë për lejimin e ankuses për të takuar fëmijën çdo ditë për një periudhë kohore dy mujore me qëllim ushqyerjen me gji të saj. Ndërkohë është punuar nga stafi për përgatitjen psiko-emocionale të të paraburgosurës deri në ndërprerjen e këtij procesi (ushqyerjen me gji).

Më pas, ajo ka realizuar 4 takime në muaj me familjarët në ambientin e takimeve familjare. Përveç kësaj ajo është lejuar që të bënte edhe 3 takime në javë me nga 4 orë çdo takim me fëmijën e saj në ambientin e përshtatur për realizimin e këtij programi në regjimin e brendshëm të paraburgimit.

Në vazhdimësi, duke qënë se gjendja e ankuses është përmirësuar dhe fëmija i saj është në moshë më të rritur se në fillim, nga stafi është informuar lidhur me të drejtat e parashikuara në aktet normative që rregullojnë veprimtarinë e IEVP-ve dhe është punuar për përshtatjen e saj me rregullat e këtij institucioni.

Nisur nga kushtet objektive të këtij institucioni, në të cilin është vetëm një dhomë me hapësirë të vogël ku aktualisht realizojnë takime me fëmijët nga 0-14 vjeç 10 të paraburgosura, për organizimin e përgjithshëm të takimeve të të paraburgosurave të cilat realizojnë takime në ambientin e prindërimit në distancë dhe që janë pjesë e kësaj liste, është vendosur që numri i takimeve me familjarët të jetë 4 në muaj por të kenë mundësinë e qëndrimit më pas në këto ditë vetëm me fëmijët deri në 5-6 orë.

Gjithashtu në këtë përgjigje informohemi se, me këtë mënyrë organizimi mundësohet që për të gjitha të paraburgosurat që janë pjesë e programit “Prindërimi në distancë”, jo vetëm ofrohet trajtim i barabartë, por përmbushen edhe detyrimet që rrjedhin nga aktet normative në fuqi të cituara më sipër.

Referuar përgjigjes së dërguar nga IEVP “Ali Demi” dhe akteve normative të sipërpërmenduar, nga ana formale duket sikur (të krijohet përshtypja) nuk konstatojmë që ankueses t’i jetë cënuar ndonjë e drejtë e parashikuar në aktet normative në fuqi lidhur me rastet dhe kohën e takimeve me fëmijën e saj të mitur.

Mirëpo referuar standardeve ndërkombëtare për përmirësimin e mirëqënies së fëmijëve, frymës së Konvetës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe parimit të “interetit më të lartë të fëmijës”, si një ndër parimet kyçe në drejtim të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, implementuar drejtëpërdrejt në të drejtën tonë të brendshme, konkretisht në ligjin nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, i ndryshuar dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr. 437, datë 20.05.2015, konstatojmë se, veprimet e administratës së IEVP “Ali Demi” me këtë kategori personash nuk janë në nivelin e standardit të kërkuar.

Sjellim në vëmendje se në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998, të ndryshuar dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, është parashikuar dhe garantuar kontakti me botën e jashtme i të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim dhe konkretisht:

a) Në nenin 40 “Lidhjet me familjen” të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 parashikohet se:

“Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të paraburgosurit dhe të të dënuarve me familjen.

I paraburgosuri dhe i dënuari mund të informojë menjëherë familjarët për futjen e tyre në një institucion ose kur transferohet prej tij.

Në rast vdekjeje ose sëmundjeje të rëndë fizike ose psikike të një të paraburgosurit dhe të dënuari, duhet të njoftohen menjëherë familjarët.

Institucioni njofton menjëherë të paraburgosurit dhe të dënuarin kur vihet në dijeni për vdekjen e të afërmëve të tij.

Për të paraburgosurit dhe të dënuarit e mitur dhe për gratë që kanë fëmijë të mitur, bëhet një program i posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen.

b) Në nenin 40 “Takimi me familjen, të afërmit dhe miqtë” të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve parashikohet se:

“1. Të paraburgosurit apo të dënuarit kanë të drejtë të takohen 4 herë në muaj me familjarët, të afërmit dhe miqtë e tyre. Të paraburgosurit apo të dënuarit e mitur kanë të drejtë të takohen me familjarët 8 herë në muaj. Drejtori i IEVP-së mund të japë takime shtesë të arsyetuara për të paraburgosurit apo të dënuarit.

2. Takimet e zgjatura lejohen deri në 5 orë për të dënuarit e martuar ose bashkëjetues, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin e Familjes.

3. Takimet bëhen çdo ditë sipas orarit të veprimeve, në vendet e përcaktuara në rregulloren e IEVP-së.

4. Në çdo takim lejohen fëmijët e mitur dhe tre persona madhorë.

5. Drejtori i IEVP-së, me vendim të prokurorit apo të gjykatës, kufizon të drejtën e të paraburgosurit apo të të dënuarit të presë vizita, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.”

c) Në nenin 57 “Prindërimi në distancë” të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, parashikohet se:

“1. Prindërimi në distancë synon forcimin e marrëdhënieve me familjen dhe përgatitjen për riintegrim me përqendrim të veçantë tek të miturit dhe gratë.

2. Prindërimi në distancë zhvillohet në mjedise të veçanta të institucionit, të përshtatura për zbatimin e këtij programi, ku të dënuarit dhe të paraburgosurit shpenzojnë deri në 8 orë me familjen.”

ç) Ndërsa në nenin 69 “Gratë e dënuara me fëmijë deri në 3 vjeç” të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, parashikohet se:

1. Grave me fëmijë deri në 3 vjeç, për shkak të situatës së veçantë të tyre, u kushtohet një vëmendje e veçantë gjatë procedurave të pranimit në institucion.

2. Gjatë pranimit ose kryerjes së dënimit të grave me përgjegjësi përkujdesjeje për fëmijë të kësaj grup-moshe, institucioni duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës ndihmon lidhur me marrëveshjen për fëmijën.

3. Të dhënat personale të fëmijës të së paraburgosurës dhe të së dënuarës që pranohet në institucion regjistrohen gjatë pranimit të së dënuarës. Regjistri përfshin të paktën emrin dhe moshën e fëmijës, si dhe të dhëna të tjera në bazë të legjislacionit në fuqi për të dhënat personale.

4. Për fëmijët deri në 3 vjeç, që nuk shoqërojnë nënën në institucion, regjistrohet vendndodhja dhe statusi i kujdestarisë.

5. I gjithë informacioni që lidhet me identitetin e fëmijës ruhet si konfidencial, dhe përdorimi i këtij informacioni duhet të jetë gjithmonë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Sistemimi i fëmijës bëhet në seksione të veçanta për nënat me fëmijë brenda IEVP-së, me personel të kualifikuar.

7. Kur fëmijët arrijnë moshën 3-vjeçare ose për arsye të tjera të ligjshme, sistemimi i tyre bëhet sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se, bazuar në evidetimin e problematikës së lartpërmendur në IEVP “Ali Demi” Tiranë, ekzistencës së vetëm një dhome me hapësirë të vogël ku aktualisht realizojnë takime me fëmijët nga 0-14 vjeç 10 të paraburgosura, si dhe për të garantuar zbatimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, domosdoshmërisht lind nevoja e krijimit të kushteve objektive në këtë institucion. Kemi bindjen se ndërtimi i këtyre ambienteve të veçanta me kushte të përshtatshme do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e mirëqënies së fëmijëve, në forcimin e marrëdhënieve të kësaj kategorie me familjet, por edhe në përgatitjen e tyre për ri-integrim në shoqëri pas përfundimit të dënimit penal.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrate publike*”, dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme për zgjerimin/ndërtimin në IEVP “Ali Demi” Tiranë të ambienteve të tjera të takimit të të paraburgosurave dhe të dënuarave me fëmijët e tyre të mitur, me qëllim garantimin e respektimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe për respektimin e të drejtës së prindërimit në distancë në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë.

2. Marrjen e masave organizative për të bërë të mundur shtimin e numrit dhe të kohës së takimit të të paraburgosurave dhe të dënuarave me fëmijët e mitur, si dhe me familjarët e tyre.

3. Marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e më shumë takimeve të ankueses M.C. me fëmijën e saj të mitur E.C..

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi